



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

*Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.*

## **RAPORTI GJYSËMVJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2021 MINISTRIA E BRENDSHME**

### **1. Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)**

Gjatë vitit 2021, sipas Planit të Veprimit për konsultimin publik Ministria e Brendshme (MB) ka planifikuar konsultimin e 14 (katërmbëdhjetë) projektakteve: 6 (gjashtë) projektligje dhe 8 (tetë) projektvendime. Këto projektakte janë të parashikuara edhe në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) për 2021, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1121, datë 30.12.2020, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021”<sup>1</sup>.

Nga numri total i akteve të planifikuara sipas PV, për periudhën Janar – Qershor 2021 Ministria e Brendshme ka realizuar procesin e konsultimit publik për 5 projektakte, pra ka realizuar 35% të planit të saj të konsultimit publik.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se ka pasur një numër total prej 1036 vizitorësh për projektaktet e konsultuara në këtë platformë dhe të miratuara dhe nga Këshilli i Ministrave. Ndërkohë që konsultimi publik është realizuar edhe nëpërmjet tryezave të konsultimit publik, ku ka pasur përfaqësi nga disa grupe interesi të cilët kanë dhënë kontributin e tyre.

### **2. Analiza e konsultimeve të kryera**

#### **2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike**

Numri i përgjithshëm i akteve të planifikuara për Ministrinë e Brendshme për konsultim publik sipas Planit të Veprimit për vitin 2021 është 14 (katërmbëdhjetë) projektakte, si vijon:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut””;
2. Projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të

<sup>1</sup> Shih PPAP 2021 në: <https://qzb.gov.al/eli/vendim/2020/12/30/1121/0432c4b1-7aa0-4781-a383-00cba2409b07;q=analitik>

policisë së burgjeve, të policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

3. Projektligji “Për gjendjen civile”;
4. Projektligji “Për sistemin e adresave”;
5. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Kriminalistikës”;
6. Projektligji “Për Policine Bashkiake”;
7. Projektvendimi “Për një ndryshim në VKM nr. 421, datë 13.05.2015 “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”;
8. Projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM Nr. 275, datë 01.04.2015 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”;
9. Projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 94, datë 4.2.2015 “Për procedurat për armët në rastet e vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”;
10. Projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 95, datë 4.2.2015 “Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme”;
11. Projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 96, datë 4.2.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe aftësimit për armët e koleksionit”;
12. Projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 348, datë 29.04.2015 “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive "B", "C", e "D" në territorin e Republikës së Shqipërisë”;
13. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023”;
14. Projektvendimi “Plani i Veprimit 2022-2024 i Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024”.

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore.

Në zbatim të urdhrit nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”, konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun, pra jo vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1, të ligjit të sipërcituar. Ndërsa në nenin 4, të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik“ është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj. Rrjedhimisht aktet e Ministrisë së Brendshme të cilat janë

të kësaj natyre, janë përjashtuar nga ky proces, duke i evidentuar në planin e veprimit, sipas përjashtimit përkatës.

### **2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?**


Numri i përgjithshëm i projektakteve të planifikuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2021, për Ministrinë e Brendshme është 37, nga ku janë miratuar 7 akte. Nga këto 7 akte të miratuara, 5 prej tyre janë akte të planifikuara dhe në Planin e Veprimit të konsultimit publik, konkretisht 5 projektvendime që dalin në zbatim të ligjit “Për armët” dhe të cilat i janë nënshtruar dhe këtij procesi.

Njësoj si një vit më parë, numri i akteve të paplanifikuara dhe të miratuara është më i lartë se numri i akteve të miratuara si të parashikuara më PPAP. Pra nga numri i përgjithshëm i akteve të miratuara për MB gjatë vitit 2021, kemi: 7 akte nga 37 akte pjesë e PPAP 2021 dhe 15 akte nga 20 akte të paplanifikuara në PPAP.

### **2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?**

Nga 14 projektakte të planifikuara për konsultim publik për Ministrinë e Brendshme janë konsultuar 5 projektakte, pra janë konsultuar 35% e planit. Krahasuar më një vit më parë, ku gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2020, Ministria e Brendshme kishte kryer konsultimin publik për 35% të akteve, edhe këtë vit mbetemi në shifra të njëjtë, për këtë periudhë raportimi.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2021, kemi një numër më të lartë të akteve që realisht i janë nënshtruar këtij procesi nëpërmjet RENJK apo tryezave publike, por që nuk janë miratuar ende nga Këshilli i Ministrave.



9 akte nga 14 akte të planifikuara për konsultim publik sipas planit të veprimit nuk janë konsideruar të kryera për arsye si më poshtë:

- 5 prej tyre janë parashikuar të hartohen nga grupet e punës dhe të miratohen gjatë katërmujorit të III-të PPAP 2021, pra do të jenë pjesë e raportimit vjetor të MB;
- projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të policisë së burgjeve, të policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të

Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, *parashikuar për katërmujorin e II-të të këtij viti, por nuk ka përfunduar akoma drafti nga grupi i punës.*

- projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023”, dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”, *i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet RENJK dhe tryezave publike, por nuk janë miratuar ende nga Këshilli Ministrave,*
- projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 421, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”, *i është nënshtruar procesit të konsultimit publik dhe aktualisht është në fazë miratimi nga Këshilli Ministrave.*

Për sa i përket projektligjit "Për disa ndryshime në Kodin Penal, nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, në Nenin 183 “Falsifikimi i monedhave” dhe Nenin 185 “Prodhimi mjeteve për falsifikim”, nuk është planifikuar si projektakt i planifikuar për konsultimin publik të MB për 2021, dhe rrjedhimisht nuk bërë pjesë e statistikave, pasi është dakordësuar nga të dy institucionet MD dhe MB, që *ky akt ti nënshtrohet KP nga institucioni iniciues dhe kompetent për natyrën e aktit, pra Ministria e Drejtësisë.*

### ***2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?***

Për periudhën janar – qershor 2021 nuk janë konsultuar akte të cilat shoqërohen me VNR, pasi këtij procesi gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar vetëm projektvendimet, të cilat nuk kanë pjesë përbërëse të paketës së tyre hartimin dhe shoqërimin me VNR. Aktet e planifikuara për konsultim dhe që do të jenë të shoqëruara me VNR janë në katërmujorët e tjerë të vitit.


### ***2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?***

Nga 37 projektakte, të cilat janë në përputhje me PKIE, PA dhe Dokumentet Strategjike, për 22 projektakte janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike, ku pjesa më e madhe e tyre është përjashtuar për kriterin e natyrës individuale të aktit administrativ, apo çështje të sigurisë kombëtare.

Më konkretisht:

- 7 akte janë përjashtuar për kriterin “*çështje të sigurisë kombëtare*”;
- 14 akte janë përjashtuar për kriterin “*aktet administrative individuale dhe aktet administrative normative*”;
- 1 akt është përjashtuar për kriterin “*marrëdhënie ndërkombëtare dhe marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe*”.

### Kriteret/përjashtimet nga konsultimi publik



Krahasuar me një vit më parë, numri i akteve të përjashtuara nga ky proces sipas motiveve sa më sipër është më i reduktuar. Në vitin 2020, 35 akte kanë qenë të përjashtuara si akte administrative individuale apo me karakter normativ, ndërkohë që për këtë vit, numërohen vetëm 14 akte të tilla.

#### **2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?**

Aktet e konsultuara janë kryesisht projektvendime, ku përfshihen edhe strategjitë e ndryshme. Konkretisht i janë nënshtruar konsultimit publik 5 projektakte nga 14 projektakte, nga të cilat të gjitha janë projektvendime.

#### **2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?**

Krahasuar me një vit më parë, konkretisht konsultimi në vitin 2020, në 2021 vihet re një numër më i madh akteve të parashikuara të konsultuara, të cilat janë konsultuar si nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimin dhe konsultimin (RENJK), ashtu edhe nëpërmjet takimeve konsultative me gupet e interesit. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një organizim më të madh të takimeve konsultative fizikisht, të zhvilluara në të dyja fazat: si në fazën paraprake ashtu edhe në fazën e konsultimit publik, referuar lehtësimit të masave shtrënguese, por edhe mundësia e zhvillimit të takimeve nëpërmjet platformave online është një metodë tjetër që favorizon përfshirjen e një grupi më të madh të palëve të interesuara.

### **2.2. Metodat e konsultimit**

#### **2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)**

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. Konsultim gjatë hartimit të draftit të aktit nëpërmjet grupit të punës dhe ekspertizës së ekspertëve të ndryshëm sipas fushave përkatëse, apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat asistojnë institucionin tonë;
2. Tryeza të konsultimit publik pas përgatitjes së aktit, me aktorët e targetuar si: shoqëri civile, shoqata, organizata kombëtare po ndërkombëtare (të zhvilluara fizikisht apo online për shkak të pandemisë);

### 3. Konsultimi në faqen zyrtare të regjistrit elektronik për konsultimin dhe njoftimin (RENJK).

Të gjitha projektaktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, janë konsultuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, si dhe konsultimit nëpërmjet tryezave publike fizikisht apo online.

#### ***2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?***

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit.

Numri i komenteve përmes konsultimit në fazën paraprake të draftimit të aktit, ka qenë i lartë referuar ekspertizës së ekspertëve të ndryshëm, njohës të mirë të fushave përkatëse sipas akteve, si dhe ekspertëve përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim asistencën me ekspertë të Zyrës së Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta SEESAC, të cilët kontribuan në hartimin e akteve nënligjorë në zbatim të ligjit “Për armët”.

Për sa i përket konsultimit publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK), bëjmë me dije se nuk ka pasur asnjë koment edhe pse numri i vizitorëve në këtë portal për aktet e konsultuara ishte 1036.

#### ***2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?***

Ministria e Brendshme ka zhvilluar konsultime paraprake me teknikët apo ekspertët njohës të mirë të fushës së aktit, gjatë fazës së hartimit të këtyre akteve:

- projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM Nr. 275, datë 01.04.2015 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”;
- projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 94, datë 4.2.2015 “Për procedurat për armët në rastet e vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”;
- projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 95, datë 4.2.2015 “Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme”;
- projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 96, datë 4.2.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe aftësimit për armët e koleksionit”;
- projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 348, datë 29.04.2015 "Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive "B", "C", e "D" në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Këto akte për shkak të natyrës teknike apo komplekse, i janë nënshtruar konsultimit paraprak gjatë draftimit në grup pune në bashkëpunim me ekspertët e fushës të Drejtorisë së Përgjithshme

të Policisë së Shtetit, si dhe me asistencën e veçantë të ekspertëve të Zyrës së Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta SEESAC.

### **2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve**

#### **2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?**

Për të gjitha aktet objekt shqyrtimi të procesit të konsultimit publik, është kryer publikimi në RENJK, duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditë pune. Për as i përket konsultimeve nëpërmjet metodave të tjera, ato janë zhvilluar për një periudhë më të gjatë, duke përfshirë disa muaj, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë të secilit akt. Pra të 5 projektvendimet në zbatim të ligjit “Për armët”, janë konsultuar për rreth 4 muaj.

#### **2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?**

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2021, u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditë pune duke filluar nga data e publikimit.

Kurse kohëzgjatja mesatare e projektakteve të konsultuara nëpërmjet të gjitha metodave të konsultimit, duke përfshirë dhe konsultimin paraprak, ka qenë afërsisht 2 muaj. Kjo mesatare është rezultat i mbledhjes së të gjitha afateve të kohëzgjatjes së procesit të konsultimit, duke përfshirë dhe fazën paraprake, pjesëtuar për numrin e akteve të konsultuara.

#### **2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim më të madh të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike. Kurse të dhënat e përfituara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të një viti më parë.

Situata këtë vit është përmirësuar, kjo sepse ka pasur një angazhim më të madh të rolit të koordinatorit të procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, kjo dhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në të kuptuarit më mirë të rëndësisë dhe në menaxhimin më të mirë të këtij procesi, si dhe në bashkëpunimin me efektiv me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

### **2.4. Palët e interesuara të përfshira**

#### **2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?**

Për vitin 2021 ka pasur një numër të madh të pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, konkretisht:

- Misionet/partnerët ndërkombëtare që ofrojnë bashkëpunim në fushën e sigurisë për Ministrinë e Brendshme si SEESAC.

- Organizata të tjera ndërkombëtare apo private si UNICEF.
- Aktorë qeveritarë si anëtarë të Komiteteve Rajonale (KRAT) të qarqeve: Tiranë, Dibër, Shkodër, Kukës, Korçë dhe Vlorë, prefektët e qarqeve dhe administratat e tyre, kryetarët e Bashkive dhe kryetarë të Këshillave Bashkiak.

#### ***2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)***

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2021, ka pasur pjesëmarrje nga ekspertë të ndryshëm, të cilët janë kontraktuar nga MB ose kanë dhënë asistencën e tyre nëpërmjet takimeve të ndryshme konsultuese si:

- ekspertë individual,
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, dhe
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë.

#### ***2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?***

Ekspertët e fushave të ndryshme, kryesisht të sigurisë, apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të përmendura sa më sipër, kanë dhënë kontributin e tyre konkretisht për 5 aktet e miratuara, për shkak të natyrës së tyre teknike apo komplekse.

Aktet i janë nënshtruar konsultimit publik nëpërmjet një workshop-i të zhvilluar me anëtarët e grupit të punës, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës së armëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe me asistencën e veçantë të ekspertëve të Zyrës së Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta SEESAC.

Palët e interesuara në këtë proces, si anëtarët e grupit të punës, ashtu edhe përfaqësuesit e SEESAC patën shumë diskutime dhe ndërveprime ndërmjet tyre me qëllim përmirësimin e drafteve, referuar dhe faktit që këto akte sikurse edhe ligji “Për armët”, synuan përafrim me disa prej direktivave të BE-së.

Më konkretisht numri i pjesëmarrësve në këtë workshop ka qenë 8 persona.

#### ***2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?***

Aktet i janë nënshtruar konsultimit publik nëpërmjet një workshop-i të zhvilluar me anëtarët e grupit të punës, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës së armëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe me asistencën e veçantë të ekspertëve të Zyrës së Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta SEESAC.

Palët e interesuara në këtë proces ishin si anëtarët e grupit të punës, ashtu edhe përfaqësuesit e SEESAC.

Më konkretisht:



- **Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** pati 4 pjesëmarrës, si anëtarë të grupit të punës;
- **Nga Ministria e Brendshme** pati 2 pjesëmarrës, si anëtarë të grupit të punës;
- **Nga SEESAC** pati 2 ekspertë të ftuar për të dhënë kontributin dhe konsultimin e tyre në workshop.

#### **2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Brendshme.

Gjithashtu, është përmirësuar edhe sepse ka pasur një angazhim më të madh të rolit të koordinatorit të procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, kjo dhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në të kuptuarit më mirë të rëndësisë dhe në menaxhimin më të mirë të këtij procesi, si dhe në bashkëpunimin me efektiv me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

### **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

#### **2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?**

Nga konsultimi përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, nuk ka pasur asnjë koment për aktet e publikuara dhe të konsultuara sipas kësaj metode. Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë përmes tryezave të konsultimit të zhvilluara fizikisht.

Nga sa raportohet nga anëtarët e grupeve të punës dhe struktura teknike të hartimit të këtyre akteve, raporti i rekomandimeve të marra gjatë kësaj faze është 16 në total, për të gjitha aktet e konsultuara, nga të cilët janë reflektuar 10 rekomandime dhe janë refuzuar 6. Pra janë pranuar rreth 63% e rekomandimeve të marrë gjatë fazës së konsultimit publik.

#### **2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?**

1. Projektvendimi **“Për disa ndryshime në VKM Nr. 275, datë 01.04.2015 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”**- 3 rekomandime të marra, nga të cilat u reflektuan 2 prej tyre.
2. Projektvendimi **“Për disa ndryshime në VKM nr. 94, datë 4.2.2015 “Për procedurat për armët në rastet e vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”** – 3 rekomandime të marra, nga të cilat 2 u morën parasysh.
3. Projektvendimi **“Për disa ndryshime në VKM nr. 95, datë 4.2.2015 “Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme”** – 4 rekomandime të marra, nga të cilat u morën parasysh 2 prej tyre.
4. Projektvendimi **“Për disa ndryshime në VKM nr. 96, datë 4.2.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe aftësimit për armët e koleksionit”** - 3 rekomandime të marra, nga të cilat u reflektuan 2 prej tyre.

5. Projektvendimi “Për disa ndryshime në VKM nr. 348, datë 29.04.2015 "Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive "B", "C", e "D" në territorin e Republikës së Shqipërisë” - 3 rekomandime të marra, nga të cilat u reflektuan 2 prej tyre.

### **2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?**

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme, duke theksuar një përmirësim gjatë këtij viti krahasuar me një vit më parë, pasi në vitin 2020 konstatojmë refuzimin e komenteve për 2 akte, konkretisht projektligji “Për armët” dhe projektligji “Për të huajt”. Për sa i përket vitit 2021, komentet e marra gjatë fazës së konsultimit publik janë pranuar dhe reflektuar në akte.

### **2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?**

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik, pasi nuk janë publikuar akte me VNR.

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### **2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?**

Ministria e Brendshme ka publikuar në RENJK 5 raporte konsultimi për të 5 aktet e të konsultuara dhe që njëkohësisht janë miratuar nga Këshilli Ministrave.

### **2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?**

Nuk ka raporte të pa publikuara për aktet e konsultuara. Çdo akt i konsultuar nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, është shoqëruar me raportin e rezultateve të këtij procesi, pavarësisht nëse janë marrë komente apo jo.

## **2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik**

Referuar formatit të kërkuar nga njësia përkatëse në Kryeministri, e cila është hartuar nga MB argumentojmë si vijon:

Indeksi Performancës për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme është 7.25. Ky rezultat vjen si pasojë e kësaj llogaritjeje:

a) 35 është shuma e pikëzimit për procesin e KP, pjesëtuar për numrin e akteve të konsultuara që është 5, indeksi rezulton të jetë **7 pikë** për cilësinë e konsultimit publik për 6 mujorin e I-rë për Ministrinë e Brendshme.

Kurse në përqindje indeksi sasior rezulton **35%**. Ky rezultat vjen si pasojë e llogaritjes:

b) 5 akte nga PPAP, të cilat janë miratuar i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik nga 14 akte të planifikuara në total për këtë proces.

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Brendshme, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.